



Procesverbal nga mbledhja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Nr. 33

Datë: 23. 06. 2017, ora: 14:30

Vendi: Selia e KQZ-së/Prishtinë

Kryesuese e mbledhjes: Valdete Daka, kryetare e KQZ-së

Në mbledhje morën pjesë anëtarët e KQZ: Betim Gjoshi, Sami Hamiti, Ilir Gashi, Adnan Rrustemi, Binak Vishaj, Eshref Vishi, Nenad Rikallo, Ercan Spat, Bajram Ljatifi, Ergit Qeli.

SKQZ: Enis Halimi, Krye shëf i SKQZ. Miradije Mavriqi, drejtoreshë e ZRPPC.

Përkthyes: Vera Dula. Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi (ZLKMP).

RENDI I DITËS

1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së;

-Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes të KQZ-së nr.26 dhe 27 /2017

2. Raport nga Qendra e Numërimit dhe Rezultateve (QNR)

3. Raport i Këshillave të KQZ-së;

- Këshilli për Operacione Zgjedhore;

- Shqyrtimi dhe miratimi i Draft Planit Operacional për Zgjedhjet Lokale 2017 dhe Kalendarit të aktiviteteve kryesore për Zgjedhjet Lokale 2017;

4. Shqyrtimi dhe miratimi i kufizimeve të shpenzimeve të fushatës për subjektet politike;

5. Të ndryshme

1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së

Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes të KQZ-së nr.26 dhe 27 /2017

Valdete Daka: Mirë se keni ardhur në mbledhjen e 33 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në rendin e ditës hyn në propozim të cilin e keni para jush, a kemi ndonjë propozim

Betim Gjoshi: Kryetare ndoshta jo për vendim marrje por është më mirë tek pika e fundit me biseduar sepse e kemi të vështir sepse si analizë por edhe disa edhe pse zgjedhjet janë shkuar mirë janë vlerësuar nga të gjithë kemi pas disa defekte gjatë procesit zgjedhor por të cilat është mirë të bisedojmë ndoshta sot që me pas si mundësi ndoshta mu ul bashkë me bo një analizë ma të mirë që mos me na u përsëritë në zgjedhjet lokale një prej tyre na të gjithë e dimë e kemi pas numrin më të madh të fletëvotimeve po thuajse në historinë e zgjedhjeve në Kosovë para ndërruar procesi zgjedhor kështu që ka qenë mirë ndoshta me biseduar sot rreth masave rreth mekanizmave që duhet të ndërmerren që ne me pas si proces sa më të mirë edhe disa tema rreth listës votuese çështje të tjera që ndoshta është mirë të bisedojmë me ndryshme sot për me caktuar një ditë kur me u ulur e me analizuar gjithë së bashku kur jemi më të lirë me pas se çka mundemi me ndërmarr.

Valdete Daka: Në rregull atëherë kush është për këtë rend të ditës në këtë shtesë d.m.th të ndryshme. Faleminderit. Vazhdojmë me pikën e parë, ato janë procesverbalet miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve 26 dhe 27. A ka dikush vërejtje? Nëse jo kush është për miratimin e këtyre raporteve? Faleminderit. Vazhdojmë me pikën tjetër Raport nga Qendra.

Betim Gjoshi: Kryetare para se me filluar nëse kishte pasur mundësi kam menduar që do të ketë aktivitete të sekretariatit kam pyetur sekretariatit diçka, po konsideroj që është pjesë e tyre. Para se me filluar me raportet, ne e dimë të gjithë që është përkujdesur që institucionet e Kosovës para festës me i ekzekutuar pagat për neve që jemi punëtorë të rregullt. Por, ne si institucion që nga dita e zgjedhjeve një muaj e gjysmë kemi qindra punëtorë të angazhuar edhe desha të pyes sekretariatit qa ka bërë që ti kryej obligimet që i kanë para festave, cila ka qenë pengesa nëse eventualisht nuk i ka kryer deri më tani, por të kihet parasysh që i kanë bërë një muaj?

Valdete Daka: Po urdhëro Kryeshef.

Enis Halimi: Faleminderit. Unë nuk kam tash shënimet e fundit por, unë e di që i kanë nënshkruar kontratat brenda kohës optimale për një ekzekutim me kohë të pagesave. Ju e dini që këto pagesa bëhen prej një kategorie tjetër, jo nga kategoria e pagave me mëditje. Por, për sa i përket neve me gjithë telashet që i kemi pasur në procesim ne i kemi ne i kemi kryer obligimet tona ndërkaq për aspektin teknik të ekzekutimit final të këtyre nga ministria e financave nuk jam në dijeni, po të dija më par pyetjen ndoshta do të përgjigjesha por, ndoshta më vonë e marr si konfirmim. Faleminderit.

Betim Gjoshi: Kryetare, në bazë të informatave që unë kam kontratat janë nënshkruar pas kohë d.m.th. pasi e kanë bërë një muaj ka filluar procesi i nënshkrimit të kontratave dhe nuk ju kanë ekzekutuar pagesat, nuk kemi nevojë për përgjigje diplomatike, pyetje konkrete bëra. Edhe është neglizhencë e tyre që nuk i kanë përfunduar, se për veti i kanë marr kryetare.

Sami Halimi: Kryetare, pasi u hap kjo temë duhet me ju tregu që ata nuk mund ti marrin pagat, lëreni aspektin teknik, e dimë që aspekti teknik nuk ka shana të ekzekutohet tash, i din këta që punëtorët atje

nuk munden mos të mbetet kjo që a do të mund ti marrin apo nuk do ti marrin, ata nuk do ti marrin sepse nuk janë të proceduara me kohë. Edhe pavarisht a shkon prej kategorisë së pagave apo të mallrave apo shërbimeve nëse ishin procesuar me kohë ishin Përfunduar. Pra, mos të mbetet temë tash dilmë thuaj sot është e premtë edhe ajo punë nuk mund të ekzekutohet para festës , pas festës sigurisht po.

Enis Halimi: Ne është e vërtetë që për shkak të angazhimeve e kemi jo vonuar por, shty nënshkrimin në kuptimin teknik të fjalës por, ne nuk mund të paguajmë stafin për punën të cilën ende nuk e ka përfunduar. Një pjesë të stafit është e vërtetë nuk e kemi angazhuar ndoshta që në fillim të zgjedhjeve por, edhe një pjesë tjetër ende nuk i ka bërë një muaj pjesa më e madhe e tyre. Kështu që jemi në proces, nuk po them që është zgjidhja më e mirë por, jemi në proces për ta realizuar një obligim të tillë.

Valdete Daka: Burim urdhëro për raport.

Burim Ahmetaj: Faleminderit kryetare. Te nderuar anëtar të komisionit të zgjedhjeve, qendra e numërimit të rezultateve është në rinumërimin e 280.000 votimeve të cilat nuk kanë mundur të kalojnë auditimin të problemeve apo në mos përputhje të qendrës së numërimit të rezultateve në ato të njëjta që kanë pas, mos përputhje të subjekteve për kundrejt votave të kandidatëve, subjektet kanë pasur vota dhe kandidatët nuk kanë pasur, dhe rastet tjera që kanë pasur kur kandidati apo kandidatët që tejkalojnë numrin e votave të subjektit raporti që keni ju përpara është i orës 9, dhe tash kam informacione që janë duke u numëruar të fundit dhe janë rreth 45 vend votime të cilat është dashur nga pjesa e ri numërimit të pjesshëm që do të kryhet brenda ndërrimit. Ky është informacioni që kemi brenda qendrës së rinumërimit dhe rezultateve nga poshtë, ndërsa sa i përket proceset e futjes së dhënave nga formularët e rezultateve për subjekt dhe kandidatë, pra prapë i referohemi orës 8 kur është bërë edhe raporti nga futja e të dhënave nga formularët e rezultateve për subjekte politike të proceduar 77.7%, dhe formularëve të procesuar në mënyrë me të rregull në mënyrë të kompletuara. Nga formularët e rezultateve të kandidatëve, janë 91.65%, dhe lista përfundimtare e votuesve janë 99.6%. Numri i votave me kusht të cilat janë fizikisht në momentin e rezultateve: 25.366 vota, ndërsa votat me post janë 5246 vota...

Besoju, tha z. Ahmetaj se është raportuar edhe në ditën e zgjedhjeve në një vendvotim nga komuna e Prizrenit (2063A), që nuk ka sjellë asnjë material dhe ky vendvotim konsiderohet që nuk është hapur. Kështu e trajtojmë nëse nuk ka pasur asnjë votues të bashkangjitur edhe shkresën e zyrtarit komunal të Prizrenit që e vërteton se ky vendvotim, nuk ka pasur asnjë votues. Deri më tani, është i vetmi vendvotim që nuk është sjellë asnjë material nga komuna e Prizrenit përndryshe, Qendra e Numërimit të Rezultateve para kompletimit të gjithë proceseve, bënë kontrollin e të gjithë bazave të dhënave të plotësuar të gjithë formularët të rezultateve për subjekte dhe kandidatë po ashtu bënë edhe kontrollin në mes shkrimeve në listën përfundimtare të votuesve dhe të dhënave nga rubrika nga formularët e te futjes së dhënave të rezultateve, më poshtë i kemi edhe një 2 raste të cilat ju kanë nënshtruar ri numërimit është fjala nga këto vend votime të 280 votime që ka qenë rinumërim i pjesshëm vend votimi i 28 i 02B dhe 04D tejkalon nivelin e tolerancës sepse ka 6 nënshkrime ma shumë se flet votimet ky rezultat i mos përputhjes ka dal pas rinumërimit e kemi edhe një vend votim që është në faqen e 3 nëse mundeni me kaluar gjatë rinumërimit të vend votimit 3032A/01R në komunën e Malishevës rezulton se nga ana e flet votimet nga numri serik i kemi edhe numrat serik pra mungon edhe numrat serik për 6 ama respektivisht për 6 fletëvotime është e vërtetuar sepse numri serik nga këto ana në rast se mund të rritet niveli i tolerancës sepse tani i kemi 6 fletëvotime që mungojnë atëherë do te kishte procesuar si të rregullt meqenëse janë edhe rastet nga listat përfundimtare të votuesve dhe krahasimi përkundër numrit te fletëvotimit që janë të

rregullta i kemi sjell para jush edhe katër raste të cilat ndoshta do të duhen të rinumëroheshin në mënyrë që të rregullohet gjendja e tyre pra thash edhe ma herët nga krahasimi i nënshkrimit në listave përfundimtare të votuesve dhe krahasimi në rubrikën pesë ku janë fletëvotime në formularë të rezultateve për vendvotimin në komunën e Podujevës 1811801D rezulton se në listën e votuesve janë 328 mijë nënshkrime ndërsa fletëvotimet e rregullta brenda kutisë se votimit janë 333 mijë fletëvotime.

Në bazë të procedurave të Qendrës së Numërimit të Rezultateve, tha z. Ahmetaj, është bërë një hetim lidhur me të janë numëruar fletëvotimet dhe rezulton se ka mospërputhje në mes të numrit të nënshkrimeve dhe rubrikës pesë në listën përfundimtare të votuesve si do qoftë rekomandimi është që ky vendvotim të rinumërohet më poshtë është rekomandimi për të gjitha rastet mirëpo po shkoj një nga një ta bëjë shpjegimin e radhës edhe pastaj Komisioni Qendror Zgjedhor e vlerëson nëse është e nevojshme tu bëhet zgjidhje këtyre vendvotimeve.

Në komunën e Skenderajt, tha z. Ahmetaj, janë gjithsejtë në listën përfundimtare të votuesve 418 nënshkrime ndërsa në fletëvotimet e rregullta pra brenda kutisë së votimit janë 453 pra që d.m.th që ka prapë mospërputhje në mes të numrit të nënshkrimeve dhe numrit të fletëvotimeve brenda kutisë së votimit. Rasti i tret është komuna me numër 28 15d 01d ku tregon që kanë qenë 100, ky rast pak më ndryshe se rastet tjera sepse 30 votues të cilët është dashur të nënshkruhen në listën përfundimtare të votuesve janë nënshkruar apo janë plotësuar në rubrikën e listës së votuesve me kusht. Prej këtyre 30 votuesve që faktikisht nënshkrime janë në rubrikën 5 në formularët e rezultateve janë 198 fletëvotime ndërsa nënshkrime janë 168 që d.m.th. 30 votues janë plotësuar të dhënat e tyre në listën e votuesve me kusht që është dashur të shkruheshin në listën përfundimtare të votuesve. Prej këtyre 30 votuesve 7 prej tyre nënshkruar edhe në listën përfundimtare të votuesve mirëpo janë të nënshkruar edhe në listën e votuesve me kusht, ndërsa një votues prej tyre nuk gjendet në listën e votuesve sepse posedon një numër të ID i cilin nuk figuron ne listat e votuesve. Ndërsa rasti i katërt pra, gjithmonë te krahasimi në mes të listës përfundimtare votuesve dhe numrit të fletëvotimit brenda kutisë së votimit dhe rezulton se në rubrikën 5 pra janë fletëvotime pra brenda kutisë janë 325, ndërsa ka 329 nënshkrime. Prapë edhe në këtë rast është një mospërputhje në mes të numrit të nënshkrimeve dhe numrit të fletëvotimeve brenda kutisë së votimit. Nga hetimi shihet se numri i fletëvotimeve në kutin e votimeve përputhen me 325 votues të cilët kanë votuar pra, mund të supozojmë që 4 votues janë nënshkruar në listën përfundimtare të votuesve, mirëpo fletëvotimi nuk ju ka dhënë. D.m.th. janë edhe 4 fletëvotime të fletëvotimeve të papërdorura që korespondojnë edhe me këtë numrin e nënshkrimeve.

Pra ky vendvotim apo rekomandimi, vlerësoi Ahmetaj, është që të mund procedohet si i rregullt dhe në fund e kemi rekomandimin për të gjitha këto vendvotime edhe pse vendvotimi nga komuna me numrin 28 15b01d ka një numër të madh të mospërputhjes të nënshkrimeve për kundrejt fletëvotimeve. Rekomandimi nga qendra e numërimit të rezultateve është që për dy vendvotimet të cilat janë rinumëruar 28 02B04E që e kalon numrin d.m.th. numrin e tolerancës që ka 6 nënshkrime më shumë. Vendvotimi nga komuna e Malishevës që i mungojnë fletëvotimet dhe numrat serik në ama. Si dhe këto 4 vendvotime nga krahasimi i listave përfundimtare të votuese përkundrejt fletëvotimeve brenda kutisë rregullt. Por, rekomandimi është që të rritet niveli i tolerancës për të gjitha këto vendvotime në mënyrë që të procedohen si të rregullta. Përndryshe, ndoshta as rinumërimi nuk do të mund ti zgjidh parregullsitë brenda këtyre vendvotimeve. Pra, kjo është sa i përket raportit nga qendra e rinumërimit dhe rezultateve, pra këto janë ato vendvotime e fundit të cilat kemi mospërputhje sepse këtu kemi bërë krahasimin e të gjithë bazës së të dhënave dhe posa të përfundoj ky proces i rinumërimit do të fillojmë me numërimin e

votave me kusht dhe votave me post më falni dhe pastaj të mund të fillojmë me numërimin e votave me kusht. Mirëpo nëse KQZ-ja vendos që këto vendvotime të cilat është raportuar sot të rinumërohen atëherë numërimi i votave me kusht do të mund të fillojë po sa të përfundohen këto procese. Pra kjo është sa i përket raportimit nga qendra e numërimit dhe rezultateve edhe për këto vendvotime të cilat do të duhet vendim i Komisionit Qendror. Faleminderit.

Betim Gjoshi: E kam raportin e QNR-së, por që lidhet me këtë, në lidhje me këtë vendvotimin 20 063A. E kemi edhe një rast të njëjtë edhe në komunën e Mitrovicës. I kemi këto dy qendra të votimit që nuk po arrij me i hapë asnjëherë. Realisht edhe procesi zhvillohet me ekip mobil atje, por ne na figurojnë si qendra votimi. Është mirë me e rregulluar sekretariati, mos me na u përsëritur e njëjta në zgjedhjet lokale. Edhe kjo në qytet, në Prizren. Për këto dya kemi pasur telashe. Nuk kemi arritur me i hapë, sepse nuk ka realisht edhe votues se është numër i vogël, edhe kemi vepruar gjithmonë me ekipe mobile dhe sugjeroj me vazhduar njëjtë që mos me na krijuar probleme çdo herë e na me marrë vendim që me e përjashtuar këtë qendër prej procedurave. Besoj që ka shërbime përkatëse këtu të terrenit që ish dashtë me e mbajtur shënim këto që po i flas.

Valdete Daka: Nëse nuk kemi pyetje? PO!

Adnan Rustemi: Faleminderit! Për me qartësuar. Kjo ideja e tolerancës po na rekomandohet që të kapërcej kufirin e tolerancës që e kemi përcaktuar me rregullore për dy vendvotime. Megjithatë dakord. Megjithëse na kish shërbyer me shumë me pas më shumë informacione edhe për një prezantim të tërësishëm të FPR-ve aktuale. Unë mendoj që duhet pak me analizuar, nëse jo sot, një ditë tjetër, sepse duhet me ditë pak nga ka mundur me ardhur krejt kjo situatë. Nuk është e thjeshtë me munguar 6 fletëvotime nga dengju i fletëvotimeve të papërdorura në këtë rast. Ose, si e prezantoi Burimi, duhet me pa kush kanë qenë komisionerët. Me adresuar, konsideroj unë. Unë nuk po lëshohem në detaje, por nuk mendoj që është krejt një vendvotim i tillë specifik ku, po supozojmë janë nënshkruar dhe nuk i ka marrë 6 fletëvotime.

Betim Gjoshi: A bën, kryetare? 28-shi është Zubin Potoku. Por, unë po mendoj që, ne për mos me vonuar procesin zgjedhorë është mirë, realisht sepse këtu nuk e di pse është ndarë në këtë mënyrë, janë 3 vendvotime që po propozohen të rregullta. Sepse e kemi edhe këtë 4-in te kjo rubrika edhe 2 janë shkruar me shkrim, janë 3 vendvotime. Janë 3 qëpo rekomandohet rinumërim që kanë probleme të njëjta për afërsisht. Nuk kisha menduar që nëse janë brenda kësaj tolerancës, pas rinumërimit, nëse nuk zgjidhet me rinumërim të procedohet të 6-at, që mos të na bjen edhe një herë për vendimmarrje. Tu na sjellë neve një analizë për të 6-at se si ka ardhur deri te kjo, përfshirë edhe kopjet e FPR-ve të vjetra dhe kopjet e FRK-ve të reja.

Adnan Rustemi: A mundem? Ne e dimë. S`mundemi me qenë indiferent për presionin që iu ka bërë votuesve në komuna të caktuara, sidomos në pjesën veriore, dhe konsideroj që rastet e tilla mund të na shërbejnë edhe për ta ndërlidhë dhe për ta zbardhur një proces të presionit të kontrollit të votuesve. Unë mendoj që në një rast tjetër, në një mbledhje tjetër të kemi informacione më tepër për këto vendvotime, ku mungojnë numri i fletëvotimeve përtej kufirit të tolerancës dhe të shikohet mundësia për ta adresuar në institucionet tjera.

Valdete Daka: Në fakt, ne e kemi rekomandimin që... PO, urdhëro!

Burim Ahmetaj: Nëse shënojmë në tabelë, kë ky rast më specifik në komunën e Zubin Potokut. Pra, 30 votues në vend që t'i ishin nënshkruar në listën përfundimtare të votuesve janë nënshkruar në listën e votuesve me kusht. Janë të gjitha të dhënat e tyre. Janë nënshkrimet. Në këtë rast, ose do të duhej të na lejohej një procedurë me i njohur ata votues si votues që kanë votuar si të rregullt, në mënyrë që t'i procedojmë, sepse përputhet gjithçka. Janë faktikisht 22 Votues që janë nënshkruar në listën e votuesve me kusht, qëproceduralisht nuk është dashur të nënshkruhen në listën e votuesve me kusht. Është dashur të nënshkruhen në listën përfundimtare të votuesve. Janë 7 votues që nuk është problem prej tyre, sepse 7 janë edhe në listë të votuesve edhe në listën e votuesve me kusht. Ky është rasti më specifik për dallim me rastet tjera. Të gjitha këto, nëse nuk rritet niveli i tolerancës, edhe nëse bëhet rinumërim nuk do të mund të zgjidhet problemi i tyre me këtë nivel që e kemi.

Valdete Daka: Faleminderit, Burim! Atëherë kështu, për mos me e komplikuar më shumë shkojmë me 3 kutitë të cilat janë propozuar për rinumërim. Kush është për që të rinumërohet këto 3 vendvotime? Faleminderit!

-Komisioni miratoi kërkesën për rinumërim të 3 vendvotimeve.

Betim Gjoshi: Kryetare, nëse jam i qartë, nëse rritet toleranca për të 3 është mirë me u rritë për 6-at pas rinumërimit. Sepse ndoshta rinumërimi e zgjedh problemin.

Valdete Daka: Mandej e marrim vendimin edhe për ato. Njëështë që të procesohet si i rregullt i katërti, vendvotimi i katërt. Kush është për që të procesohet ky vendvotim si i rregullt? Faleminderit!

-Komisioni miratoi kërkesën që vendvotimi numër 4 të procesohet si i rregullt.

Valdete Daka: I kemi 2 vendvotime për të cilat kërkohet që të rritet niveli i tolerancës që të mund të procesohen si të rregullta. Kush është për që këtu të rritet niveli? Përfshirë edhe ato 3, sepse e 4-ta u procedua si e rregullt. Pra, edhe për ato 3 tjerat të rritet niveli i tolerancës vetëm pas rinumërimit, jo pa rinumërim.

Burim Ahmetaj: Te tabela te numri 4 janë 4 votues, 4 nënshkrime që vetëm rritja e nivelit të tolerancës do ta zgjidhte problemi te kjo. Përfshihet edhe kjo.

Valdete Daka: Atëherë edhe për atë. Ndërkaq këto ku mungojnë fletëvotimet me siguri që do t'i dërgojmë emrat në prokurori. Nëse nuk kemi diçka tjetër për Burimin vazhdojmë me raportin e këshillave të KQZ-së. Këshilli për operacione zgjedhore.

-Raporti e këshillave të KQZ-së. Këshilli për operacione zgjedhore.

AdnanRrustemi: Faleminderit! Këshilli për operacione zgjedhore në mbledhjen e sotme ka shqyrtuar planin operacional për zgjedhjet lokale të 22 tetorit. Siç e dimë, ky dokument i integruar përfshinë çdo aktivitet në mënyrë të detajuar. Nga aktivitetet që fillojnë menjëherë pas vendimit për shpalljen e zgjedhjeve deri te dita e zgjedhjeve. Janë të përfshira të gjitha aktivitetet thelbësore të procesit zgjedhorë, nga certifikimi i subjekteve politike, përgatitja dhe certifikimi i listës së votuesve, votimi jashtë vendit, informimi i votuesve, trajnimi i komisionerëve dhe koordinimi në teren. Si të tillë, pas shqyrtimit këshilli i operacioneve zgjedhore rekomandon KQZ-në që ta miratoj. Natyrisht që, anëtarët nëse kanë ndonjë pyetje ose sqarim shtesë, sekretariati mund ta ofroj dhe eventualisht ndonjë plotësim.

Valdete Daka: A kemi ndonjë pyetje? Nëse jo, kush është për?

Betim Gjoshi: Kryetare! Ne i kemi pasur disa praktika që me pas kanë vërejtur gabime në plan operacional dhe kanë menduar nëse teknikisht duhet me shkuar me ndryshuar të IT-ja. Është mirë nëse i shohin këto shërbimet përkatëse në fushën e vet ndonjë gabim, është mirë me sjellë në KQZ për vendimmarrje. Jo me iu dhanë njerëzve informacione me i thanë që gabim i kemi shkruar por kështu është, por ne jemi ata që prapë e ndryshojmë. Ka mundur për një ditë llogaritja e ditëve me u ngatërruar diku edhe po na sjellë problem. ne jemi munduar me analizuar aq sa kemi pas mundësi, por nuk do të thotë që kemi mundur me i llogaritë 500 operacione sakt me nje ditë nëse ata nuk i kanë llogaritë mirë shërbimet përkatëse.

AdnanRrustemi: Ky plan operacional e merr karakterin e vendimit të KQZ-së dhe si i tillëçfardo ndryshimi duhet me u sjellë këtu.

Valdete Daka: Natyrisht që sekretariati duhet ta publikoj mënjëherë në ueb faqe. Kush është për aprovimin e këtij plani operacional? Faleminderit!

-Komisioni miratoi planoperacionalpër zgjedhjet lokale të 22 tetorit.

-Shqyrtimi dhe miratimi i kufizimeve të shpenzimeve të fushatës për subjektet politike.

Valdete Daka: Shqyrtimi dhe miratimi i kufizimeve të shpenzimeve të fushatës për subjektet politike. E keni para jush njëdraftvendim për kufizim të shpenzimeve. Kufizimi i shpenzimeve për votues te regjistruar për 3 komuna, siç janëMamusha, Parteshi dhe Klllokoti do të jetë 0.70 për votues, ndërsa për komuna tjera do të jetë 0.50 për votues të regjistruar në komunë. Këto 3 komuna është për shkak se ato kanë më pak se 5000 votues të regjistruar.

Betim Gjoshi: Komunat që kanë banorë më shumë se këto 3 po i bjen më pak me pas buxhet. Shembull Ranillugë ose Juniku po i bjen me pas më pak se Klllokoti ose se Parteshi.

Valdete Daka: bashkangjitur e keni edhe regjistrin me komuna, tabelën edhe me shumat e shpenzimeve të lejuar. Kush është për këtë vendim? Faleminderit

-Komisioni miratoi vendimin për kufizimin e shpenzimeve të fushatës për subjektet politike.

Valdete Daka: E kemi edhe pikën e fundit.

Betim Gjoshi: Kryetare, ne sot asnjë nuk jemi të gatshëm me i dhanë përfundim. Të gjithë e kemi nga një ide çka kemi mundur të bëjmë më mirë ose çka mundemi me bë ma mirë në të ardhmen, sepse i kemi pasur 30 ditë. Nuk ka qenë krejt faji ynë. Ka pasur ngecje. Sekretariati e ka ditur që ky vit është vit zgjedhorë. Ka proceduar vonë me shumë procedura tyre, edhe pse e ka ditur që ka zgjedhje të jashtëzakonshme. Ka mundur me pas edhe kontrata kornizë që i kemi dhënë në vite të caktuara, por as këtë nuk e kane vepruar. Ne i kemi disa defekte që ne i dimë pak a shumë. Unë nuk kisha dashur sot me u ndalë me i përmend këto gjëra, sepse mbi te gjitha zgjedhjet kanë shkuar mirë me ndihmën edhe të Zotit. Na ka ndihmuar me shkuar mirë, edhe palëve tjera të përfshira në proces. Por, është mirë me u përpjekë që zgjedhjet e ardhshme me u përgatitë aty ku kemi defekte, sepse ndoshta në zgjedhjet tjera zbulojmë diçka tjetër që na paraqitet. Ndonjë e papritur. E para, të zyra për certifikim të partive politike problemet që i ka pasur duhet me i rregulluar me akte, me formular që kandidatet me deklaruar përkatësinë e tyre

kur tëkandidojnë për vende të rezervuara. Edhe çështje tjera që mos me na sjellë ne para sfidave. Unë, sot e kemi vështirë me i diskutuar. Mundemi me i pas të freskëta disa, disa jo. Kështu që unë kisha kërkuar nga sekretariati fillimisht për të gjitha operacionet e veta me bë një grup punues. Me bë një analizë të shpejtë. Një vlerësim të tyre, mandej edhe ne ia përshtatim pjesën tonë edhe në bazë të tyre me i marrë disa hapa që ne me pas një proces sa më të mirë zgjedhorë për aq sa na përket ne. Gjithsesi ne duhet me i falënderuar të gjithëakterët që kanë qenë palë e zgjedhjes, partitë politike, të dërguarit e tyre, qytetarët mbi të gjitha edhe organet e gjyqësorit, policisë, forcat e sigurisë. Në përgjithësi nuk kemi pas ndonjë problem, por gjithmonë kemi qejf për më mirë. Ne duhet me i adresuar shqetësimet e publikut edhe të organizatave vëzhguese, duke përfshirë BE-në, KDI-në dhe të gjithë të tjerët që janë përfshirë në proces, dhe që i kemi pasur raportet e tyre. Mendoj që jemi këto 10 ditë janë të çmueshme për ne, sepse hyjmë në proces dhe vetvetiu procesi po na merr me vete që ne me mi marrë disa masa. Ne, edhe ne biseda me kolegë kemi parë që në disa çështje mundemi me u përfunduar më mirë dhe mendoj që mundemi me i përmirësuar. Është trajnimi, janë shumë fusha që ndoshta nuk ja vlen sot mi përmend sepse mundemi të kemi perceptim të gabuar e kur jemi në realitet mundet të jetë më ndryshe situata. Le të na sillt një analizë brenda 4-5 dite, sidomos shërbimet që nuk kanë ndonjë angazhim edhe ju bashkëngjishim edhe idetë tona secili që i kemi edhe si të kaluarën mbërrimë në një raport ndoshta që mundet të na shërbej për punë të mëtutjeshme.

Adnan Rrustemi: Pa dyshim si institucion, sidomos sekretariati si organ i KQZ-së. Po të gjithë bashkë duhet të nxjerrim mësimet nga ky proces që kudo që ka hapësirë me përmirësuar dhe mi eliminuar defektet që e kanë përcjellë e që mund të konsiderohen në këtë rast, që ka mundur me u përmirësuar ose me u shmangur ose edhe me u trajtuar në mënyrë tjetër. Përgjegjësish janë tema që po diskutohen në vazhdimësi nga informimi i edukimit të votuesve për ta zvogëluar deri në shmangie numrin e fletëvotimeve të pa vlefshme, ne gjithë e dimë që për zgjedhjet lokale numri i fletëvotimeve të pa vlefshme është shumë më i lartë se për zgjedhje të rregullta. Nëse i krahasojmë me 2013 kemi pasur 110000 fletëvotime të pa vlefshme është numër shumë i madh. Unë mendoj që duhet komplet, por po e presim një vlerësim të sekretariatit për aq sa është e mundur të ketë marrë gjitha vërejtjet parasysht edhe raportin preliminar të vëzhguesve të BE-së për qeshjet që kanë ngritur dhe për qeshjet që kemi ngritur edhe për gjatë mbledhjeve.

Por, tha z. Rrustemi, duhet ta ndërrojmë komplet qasjen për mënyrën e informimit dhe edukuese të votuese dhe duhet të sigurohemi që mesazhi jon mbërrin te votuesi duhet të mos na mjaftoj ideja që po përmbushim aktivitetin pa u siguruar që nuk është i qartë dhe nuk është i qasshëm në anën tjetër kemi me kutit e votimit duhet me marrë seriozisht këtë aspekt duhet me ditë çfarë e ka rezultuar por nëse është trajnimi aspekti që ka ndikuar ajo është përgjegjësi e drejtpërdrejt e jona dhe duhet me e vlerësuar komplet programin e trajnimit nga koha e deri te mënyra se si barten njohurit. Është votimi jashtë vendit problemi që kemi pasur me regjistrimin e votuesve jashtë vendit, është e vërtet që duhet mos me u përsërit ato pengesa që kanë qenë deri te aspektet e tjera që janë në lidhje me ditën e zgjedhjeve. Nuk e di sa ka me mundur sekretariati me na ofruar ndonjë propozim i cili mundet me qenë i adaptuese për këto zgjedhje, por pajtohem që në mbledhjen e radhës në javën e ardhshme sepse këtu nuk ka kohë për me zgjatë nëse dëshirojmë me përmirësuar këtë proces ta kemi një vlerësim bashkë me disa veprime konkrete se çfarë duhet të bëjmë për ti tejkaluar ose për ti shmangur këto.

Sami Hamiti: Faleminderit kryetare. Është e vërtet që kemi nevojë të diskutojmë për rrjedhën e procesit. Them që unë jam vonë por mbazë praktikave që kanë ndodhur që është procesi më i mirë zgjedhorë në

këto kohë d.m.th më i mirë se 2010, 2013, 2014 si proces këtë rast desha pak, prita që kryetarja faktikisht rastin e disa pjesëtareve të partive politike ose akterëve që kanë qenë në zgjedhje që e atakojnë KQZ-në. Unë do ta dal në një pozicion tjetër tash, që kërkojnë edhe dërgojnë letra të hapura edhe tregojnë çfarë po ndodh atje në Qendrën e Numërimit pse nuk po përfundon më herët, Adnani e përmendi më herët qeshjen e komisionerve është e vërtetë ata janë përfaqësues politik të partive tona që i kemi dërguar dhe nëse ka ndodhur diçka në këtë proces janë përfaqësuesit tonë politik qëi kemi dërguar tash sa ka ndodhur problemi i trajnimit të tyre, po shihet që trajnerët kanë qenë më të mirë akterët apo përfaqësuesit apo kandidatët të cilët kanë qenë e kanë instruktuar në numrat me votuar vet atje edhe kanë bërë probleme në fletëvotime atje shumica e tyre janë të votuara vetëm nga kandidatët e nuk janë partitë.

Kandidatët e partive politike, tha z. Hamiti, kanë insistuar qa shumë në ata numra në ata konotacione e veta qe kanë dëmtuar procesin edhe kjo mbërrin 50000 mijë vota. Por në këtë rast unë pashë edhe një letër që është letër e hapur e KQZ-së edhe një tjetër e përfaqësuesit politik që thotë po ndodh maskaradë në Qendër të Numërimit, me ju tregu që përfaqësuesit të cilat ato mos barazime ka ndodhur ata komisioner janë pikërisht përfaqësues të partive politike të cilat kanë marr pjesë. A duhet të trajnojnë më mirë? Unë mendoj që duhet të trajnojnë më mirë, sidomos pjesa e informimit dhe edukues të votuesve ka dështuar, andaj duhet të shihet çfarë duhet të bëjmë ne pjesën, tash na vijnë zgjedhjet lokale por edhe në anën tjetër si mesazh edhe përfruesve politik në pjesën tjetër se sa e di unë jemi në afate ligjore në procedura që janë duke ndodhur në Qendrën e Numërimit dhe tash sekretariati me ata pjesë po mundohet që problemet që kanë ndodhur në kuti thjeshtëti qes në rend nuk është duke ndodhur kurrfarë maskarade, nuk është duke ndodhur asgjë. Thjeshte po duket që po atakohet KQZ-ja për diçka që s`duhet të atakohet sepse ata përfaqësues janëpërfaqësues politik që kanë qenë në vendvotime. Faleminderit!

Bajram Ljatifi: TEKST SERBISHT (MIN-33:50)

AdnanRrustemi: Kjo çështja e kutive të rinumëruara nuk duhet me na lënë të qetë kështu si instucion duhet ta kemi parasysh qe po na përsëritet, po shtohet numri here pas here ejt, ndërkohë sistemi po mbete i njëjtë si KQZ duhet ta vlerësojmë. Unë pajtohem që duhet ta presim një raport që na prezanton QNR-ja se a bëhet fjalë për gabime matematikore, teknike a bëhet fjalë për të qëllimshme etj. Por ne e dimë që nga 210 diku 150 kanë qenë me një deri në 10 vota që madje kanë qenë edhe të subjekteve të ndryshme edhe të vogla që nuk mendoj që jepni një indikacion që nuk bëhet fjalë vetëm për trajnimin por bëhet fjalë edhe për lodhjen, unë e kam qëndrimin edhe për këtë punë. Unë konsideroj që i njëjti këshill i vendvotimit ora 5:00 e mëngjesit e ka të pa mundur me bërë numërimin e saktë dhe plotësimin e formularëve të saktë të një aktiviteti qëështë ndoshta më i rëndësishmi në fund të procesit, por le ti presim informatat le ta analizojmë gjendjen dhe le ta shohim çfarë mundemi të bëjmë në të ardhmen për ta parë duhet ta kemi synim që ti eliminojmë kutit që na vijnë për rinumërim. Duhet ta ketë synim këtë KQZ-ja dhe duhet të jetë synim strategjik mendoj unë, sikurse duhet ta ketë synim strategjik zvogëlimin e fletëvotimeve të pa vlefshme.

Valdete Daka: Faleminderit Adnan. Vetëm desha ta shtoj qëështë interesant që ata komisionerë të lodhur e ta pa trajnuar po i bëjnë shumë mirë për parti kur po vjen te kandidatët edhe nuk po dinë ti numërojnë edhe nuk po janë të trajnuar edhe krejt.

AdnanRrustemi: Rastet që janë të dyshimta duhet ti dërgojmë në prokurori.

Valdete Daka: I dërgojnë kur vjen koha. Po urdhëro Betim.

Betim Gjoshi: Unë mendoj, që ju kujtohet kam qenë i shqetësuar për këtë pjesën e numërimit të votave për parti edhe për subjekte, kandidat në këtë rast para zgjedhjeve. Por ne morëm masa vonë edhe ajo u implementuar pjesërisht, bazë informacioneve që i kemi në teren edhe asaj që po implementohet. Tash e kemi mundësinë e artë në zgjedhje lokale, për të dytë me dëshmuar veten kjo e dyta varet prej vendimeve tona, kjo e para varet prej punës së sekretariatit këtë duhet me implementuar vendimet e tona mos të na bëhet vetëm qejfi vetëm në kuptimin e unë ka vite që kërkoj ne ta bëjmë faqen tonë sa më publike, dhe t`ju kërkojmë njerëzve p.sh ku e kanë vendvotimin një reklamë nuk e bëjmë lëre më për gjërat më të thjeshta nuk ju dërgojmë kartolina qytetarëve që ju ndërrojmë vendvotimin me mijëra, mandej nuk i informojmë as që kanë mundësi të shohin ku votojnë se e dimë për vete mendojmë të gjithë është mirë të bëhet më praktik d.m.th mos të bëhet vetëm normë e përfunduar këtë punë dhe ecëm ne por ta bëjmë praktike punën sepse po ec bota sot është digjitalizuar çdo gjë. Kemi dhjetë vjet që i kemi ato të njëjtat proceduar.

Valdete Daka: Gjithsesi brenda javës së ardhshme presim nga sekretariati të na sjell disa analiza dhe disa konkluzione se ku kanë qenë pengesat dhe gabimet. Faleminderit edhe ju dëshiroj fetë të mbarë kush e feston.

Për KQZ

Valdete Daka, kryetare
